



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 50

10 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Dekret nr. 8076 datë 1.4.2013	Për transferim prokurori..... 2211
Dekret nr. 8077 datë 1.4.2013	Për transferim prokurori..... 2211
Dekret nr. 8078 datë 1.4.2013	Për transferim prokurori..... 2212
Dekret nr. 8079 datë 1.4.2013	Për transferim prokurori..... 2212
Dekret nr. 8080 datë 2.4.2013	Për dhënie të shtetësisë shqiptare 2213
Vendim i KM nr. 193, datë 6.3.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 244, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike të shtetit, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kutalli të qarkut të Beratit”..... 2213
Vendim i KM nr. 198, datë 6.3.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 2214
Vendim i KM nr. 204, datë 13.3.2013	Për një ndryshim në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 1265, datë 16.12.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Delvinë të qarkut të Vlorës”, dhe nr. 250, datë 24.4.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik” 2216

Vendim i KM nr. 217, datë 20.3.2013	Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme.....	2218
Vendim i KM nr. 218, datë 20.3.2013	Për miratimin e kufijve dhe kriterëve të përdorimit të fondit rezervë të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.....	2222
Vendim i KM nr. 219, datë 20.2.2013	Për kalimin e disa pronave në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	2222
Vendim i KM nr. 240, datë 27.3.2013	Për përcaktimin e kriterëve të tregtimit dhe të certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore.....	2229

DEKRET
Nr. 8076, datë 1.4.2013

PËR TRANSFERIM PROKURORI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 149 pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 8 pika 2 germa “c” dhe 24 pika 1 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Florian Bonjaku, aktualisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë, transferohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8077, datë 1.4.2013

PËR TRANSFERIM PROKURORI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 149 pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 8 pika 2 germa “c” dhe 24 pika 1 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Agron Gjana, aktualisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës, transferohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani



DEKRET
Nr. 8078, datë 1.4.2013

PËR TRANSFERIM PROKURORI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 149 pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 8 pika 2 germa “c” dhe 24 pika 1 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Dritan Prençi, aktualisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kurbin, transferohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8079, datë 1.4.2013

PËR TRANSFERIM PROKURORI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 149 pika 3 të Kushtetutës, si dhe të neneve 8 pika 2 germa “c” dhe 24 pika 1 të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Edmond Koloshi, aktualisht prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, transferohet prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 8080, datë 2.4.2013

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 7 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Dafina Amir Memedov
2. Dielona Bektesh Luta
3. Sylejman Zeqir Shala
4. Edon Sylejman Shala

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 193, datë 6.3.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 244, DATË 6.3.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE TË SHTETIT, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË KOMUNËS KUTALLI TË QARKUT TË BERATIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 244, datë 6.3.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në listën e inventarit që i bashkëlidhet vendimit, hiqen pronat e paluajtshme publike të tipit, pyje dhe kullota, me numrat rendorë: 1362, 1363, 1364.

b) Në lidhjen nr. 1 bashkëlidhur vendimit, shtohen pronat e paluajtshme publike, të tipit, pyje dhe kullota, me numrat rendorë 1361 dhe 1365, në pronësi, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.



2. Vendimi nr. 182, datë 13.2.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në përdorim të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Kutalli të qarkut të Beratit”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kutalli e qarkut të Beratit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: Kutalli
Qarku: Berat

Lidhja nr. 1 (shtojcë)

Numrat e pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1361, 1365	Pyll prodhues, sipërfaqe boshe	Në pronësi

VENDIM
Nr. 198, datë 6.3.2013

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1 dhe 23 pika 3 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët” shtohen individët e renditur në shkronjën “a” të listës “Lista e shtuar e individëve në listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për individët që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët.

2. Nga lista e shkronjës “A” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët” çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “b” të listës “Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si individë të çregjistruar nga anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talibanët me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

3. Në fund të shkronjës “B” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët” shtohen kompanitë e renditura në shkronjën “c” të listës “Lista e shtuar e kompanive në listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si bashkëpunëtorë ose financues për talibanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që janë bashkëpunëtorë apo financuese për talibanët.

4. Nga lista e shkronjës “C” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen individët e renditur në shkronjën “d” të listës “Lista e individëve të çregjistruar nga lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si persona të çregjistruar nga anëtarë bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

5. Në fund të shkronjës “D” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, shtohen kompanitë e renditura në shkronjën “e” të listës “Lista e shtuar e kompanive në listën e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si bashkëpunëtorë ose financues për organizatën Al-Qaida, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për kompanitë që janë bashkëpunëtorë ose financues për organizatën Al-Qaida.

6. Nga lista e shkronjës “D” “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, çregjistrohen kompanitë e renditura në shkronjën “f” të listës “Lista e kompanive të çregjistruara nga lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi si kompani të çregjistruara me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

a) Lista e shtuar e individëve në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”:

1. MOHAMMED QASIM: SADOZAI: KHUDAI RAHIM

b) Lista e individëve të çregjistruar nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talibanët”.

1. ABDUL RAZAQ: EKHTIYAR MOHAMMAD;

2. ZABIHULLAH: ZAHID: ABDUL MAJID;

3. ABDUL WAHAB: ABDUL GHAFAR.

c) Lista e shtuar e kompanive në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me talibanët”:

1. RAHAT LTD.

d) Lista e individëve të çregjistruar nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”:

1. IBRAHIM: BEN HEDHILI: BEN MOHAMED: AL-HAMAMI;

2. HABIB: BEN ALI: BEN SAID: AL-WADHANI;

3. SULAYMAN: KHALID: DARWISH;

4. SUHAYL: FATILLOEVICH: BURANOV;

5. NAJMIDDIN: KAMOLITDINOVICH: JALOLOV;

6. MADHAT: MURSI: AL-SAYYID: UMAR;

7. ADEL: ABDULJALIL: IBRAHIM: BATTERJEE.

e) Lista e shtuar e kompanive në “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”:

1. Mouvement pour l’Unification et le Jihad en Afrique de l’Ouest (MUJAO).

f) Lista e kompanive të çregjistruara nga “Lista e kompanive që i takojnë ose bashkëpunojnë me organizatën Al-Qaida”:

1. AL-HAMATI SWEETS BAKERIES;

2. BENEVOLENCE INTERNATIONAL FUND;

3. BOSANSKA IDEALNA FUTURA;

4. HEYATUL ULYA;

5. RED SEA BARAKAT COMPANY LIMITED;

6. SOMALI INTERNET COMPANY.



VENDIM
Nr. 204, datë 13.3.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 1265, DATË 16.12.2009 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DELVINË TË QARKUT TË VLORËS”, DHE NR. 250, DATË 24.4.2003 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të bashkisë së Delvinës të pronës me numër rendor 279, me emërtesë “Ish-Komisariati i Policisë, Delvinë, lagjja “Sinan Ballaci”, Delvinë”.

2. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, hiqet prona me emërtesë “Ish-Komisariati i Policisë, Delvinë”, me sipërfaqe totale të pronës 546 (pesëqind e dyzet e gjashtë) m², e me sipërfaqen e ndërtesës 108 (njëqind e tetë) m², sipas formularit bashkëlidhur, e cila i shtohet listës që i bashkëlidhet vendimit nr. 1265, datë 16.12.2009 të Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Delvinës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucioni i pushtetit qendror
MRP (Komisariati i Policisë, Delvinë)
Bashkia/komuna Delvinë
Fusha e përdorimit të pronës: ruajtje rendi

Nr. rendor	A			B			C			
	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip. totale e pronës (m ²)	Nga sip. totale, sa ndërtesë (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues, statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera Shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1				Ish-Komisariati i Policisë Delvinë	546	108	Jashtë funksionimit	MRP	Komisariati i Policisë Delvinë	
2				Komisariati i Policisë Delvinë	1006	285	Zyrat e komisaritit	MRP	Komisariati i Policisë Delvinë	



VENDIM
Nr. 217, datë 20.3.2013

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ZYRËS SË
REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

2. Kategoria e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të jetë sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kategoria e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të jetë sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Elementet përbërëse të pagës mujore të lidhjeve nr. 1 e nr. 2 janë si vijon:

a) Paga e grupit, e cila përcakton llojin e diplomës së nëpunësit, grupohet në tri nivele, sipas lidhjes nr. 3 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i pagës së grupit është niveli minimal i domosdoshëm për çdo pozicion pune dhe kategorie page. Vlera e pagës së grupit për çdo nivel është e njëjtë me vlerën e kësaj page, të miratuar për nëpunësit civilë të administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

b) Shtesa për vjetërsi në punë jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

c) Shtesa e pagës për pozicion për çdo nivel është e njëjtë me vlerën e kësaj shtese të miratuar për nëpunësit civilë të administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

ç) Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me emërtesë të njëjtë, përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së secilit institucion.

d) Shtesa për kushte pune është sipas kolonës 4 të lidhjeve të sipërcituara.

5. Niveli i pagave të nëpunësve, të cilët punojnë në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, është sipas lidhjes nr. 4 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Për punonjësit mbështetës të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, struktura e pagës dhe përlllogaritja e saj është e njëjtë me atë të punonjësve mbështetës të administratës publike, sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për ZRPP-në.

8. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 prill 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT "SPECIALIST" DERI NË "TITULLAR INSTITUCIONI" NË ZYRËN QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
(1)	(2)	(3)	(4)
Kryeregjistruesi	II-a	1	20,000
Zëvendëskryeregjistruesi	II-b	1	17,500
Drejtor Drejtorie	III-a	1	17,000
Përgjegjës sektori	III-a/1	1	12,000
Përgjegjës sektori	III-b	1	7,000
Auditues	III-b	1 ose 2	7,000
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3	12,000
	IV-b	1 ose 2, ose 3	7,000



Lidhja nr. 2

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË
NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT “SPECIALIST” DERI NË “TITULLAR INSTITUCIONI” NË ZYRAT
VENDORE TE REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NE RRETHE

POZICIONI	KATEGO RIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË	SHTESA PËR KUSHTE PUNE behet
Regjistruer i Tiranës	III-a	1	16,500
Regjistruer i rretheve të kategorisë së I-rë	III-a/1	1	16,500
Regjistruer i rretheve të kategorisë së II-të Zëvendësregjistruer i rretheve të kategorisë së I-rë	III-b	1	16,500
Zëvendësregjistruer në zyrat e kategorisë së II-të	IV-a	1	16,500
Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë	IV-a	1	12,000
Përgjegjës sektori në zyrat e regjistrimit të kategorisë së II-të	IV-b	1	12,000
Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë	IV-b	1 ose 2 ose 3	12,000
Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorisë së II-të	IV-c	1 ose 2 ose 3	8,000

Shënim. Zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë, janë zyrat: Tiranë, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë,
Kavajë, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Pogradec, Shkodër, Vlorë, Dibër dhe Sarandë.

Lidhja nr. 3

VLERA E PAGËS SË GRUPIT PËR GRUPET E DIPLOMAVE TË ARSIMIT UNIVERSITAR

Grupi i diplomës	Lloji i diplomës
1	Diplomë e Nivelit të Dytë (DND). Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë (DIND). Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë
2	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) apo të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë + Master i Nivelit të Parë (MNP)
3	Diplomë e Nivelit të Parë (DNP). Të barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë

Lidhja nr. 4

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE PËR EMËRTESAT "SPECIALIST" DERI NË "DREJTOR", TË CILËT PUNOJNË NË POZICIONE QË LIDHEN ME PROCESIN E INFORMATIZIMIT NË ZYREN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
(1)	(2)	(3)	(4)
Drejt看 Drejtorie	III-a	1	25,000
Përgjegjës sektori (Programues)	III-a/1	1	40,000
Përgjegjës sektori	III-a/1	1	25,000
Specialist (programues)	IV-a	1 ose 2, ose 3	40,000
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3	25,000
Përgjegjës Sektori ne Sektorin e Mbështetjes Teknike	III-a/1	1	15,000
Specialist ne Sektorin e Mbështetjes Teknike	IV-a	1 ose 2, ose 3	15,000
Specialist në zyrat e regjistrimit të kategorisë së I-rë	IV-b	1 ose 2, ose 3	15,000



VENDIM
Nr. 218, datë 20.3.2013

**PËR MIRATIMIN E KUFIJVE DHE KRITEREVE TË PËRDORIMIT TË FONDIT REZERVË
TË ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin vjetor të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme krijohet fondi rezervë, për të garantuar shpenzimet që rrjedhin nga dëmshpërblimet për dëmet e shkaktuara si rezultat i regjistrimit të një informacioni jo të rregullt mbi një pasuri të paluajtshme.

2. Masa e fondit rezervë përcaktohet jo më pak se 2 për qind dhe jo më shumë se 5 për qind e totalit të të ardhurave vjetore të parashikuara.

3. Masa e fondit rezervë miratohet me vendim të bordit drejtues të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas propozimit të kryeregjistruesit.

4. Përdorimi i fondit rezervë bëhet kur shpenzimet e miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor janë përdorur dhe/ose janë të pamjaftueshme, në bazë të:

i) vendimit të kryeregjistruesit, për miratimin e vendimit të veçantë të regjistruesit për të drejtën e dëmshpërblimit, sipas kërkesës së palës së interesuar, i cili duhet të jetë në pajtim me dispozitat e ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe sipas rregullave të përcaktuara nga bordi drejtues, për llogaritjen e dëmshpërblimit për dëmet e shkaktuara, si rezultat i regjistrimit të një informacioni jo të rregullt mbi një pasuri të paluajtshme; ose

ii) të një titulli ekzekutiv, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile, me objekt dëmshpërblimin, sipas parashikimeve të neneve 65, 66 dhe 67 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

5. Ngarkohet Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 219, datë 20.2.2013

**PËR KALIMIN E DISA PRONAVE NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES TEK AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas aneksit 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pronat sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, t'i tjetërsojë ato ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçantë)


Ministria e Mbrojtjes										
Komuna Dajt, Tirane										
Fusha e përdorimit të pronës:										
Per Mbrojtjen										
C										
B										
A										
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartës	Numeri pasurisë	Emertesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentet përberes të pronës	Adresa/ vendodhja e komponenteve përberes	Permasat e Pronës në M2 ose MI	Funksioni per të cilin përdoret prona	Enti me Përgjegjësi Administrative	Enti Përdorues Statusi Juridik i përdorimit	Te dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
75			Komanda FT			17500 M2	Për Mbrojtjen	MM Rep.Usht. 8800 Tirane	Rep.Usht 8800 Tirane	
			Qesarak, Tirane	Zyrat e komandës	Qesarak, Tirane	643				2 kate
				Zyrat e logarise		119				
				Postobloku		44				
				Batalioni Logjistik		176				
				Depo PH		192				
				Depo ushqimi		192				
				Depo		192				
				Depo		192				
				Truproje		114				
				Menc kuzhin		142				

2225



PLANVENDOSJA E REPARTIT USHTARAK NR. 77
BATALIONI I ZBULIMIT FERAJ-TIRANË

SISTEMI I KOORDINATAVE SHTETËRORE



SHKALLA 1:1000

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHITËTËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

MINISTRIA E MBROJTJES

Komuna QENDËR, SKRAPAR

Fusha e përdorimit të pronës :

Për Mbrojtjen Kombëtare


A			B				C			
Nr	Zona Kadast Indeksi i hartes	Numëri pasuris	Emërtesa e pronës Vendodhja/ shtrirja Gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/ vendodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e Pronës në M2 ose MI	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me Përgjegjësi Administrative	Enti Përdorues Statusi Juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1052	ZK Nr.1835 VH 4/2/05	Nr.4/2	Grup Depo M (Ish Rep. Ushk. Nr. 50/13, N/Rep.)		Radesh Skrapar	73078.5 M2	Për Mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes Brigada Logjistike	Brigada Logjistike Rep.Ushk. Nr.4300, 4303	Identifikuar me të dhënat e formularit standard dhe të planvendosjes, të dërguar nga K.M. me Nr.3212 datë 02.06.2009 dhe Br.I. Nr.4082, datë 15.09.2010.
				Zyrë truporje		106.5				
				Gabinë elektrike		9				
				Tunel gjeneratori		44				
				Depo tip tunel		927				
				Depo tip tunel		605				
				Depo tip tunel		927				
				Rrugë të brendshme		500				
				Truall		72963				



PLAN-VENDOSJA E REP. USHT.NR. 4453 Radesh Çorovodë

EMI I KOORDINATAVE SHTETERORE

--	--	--



SHPJEGUESE
SIP. E PERGJITHESHME = 73078.49 m²
SIP. ME OBJEKTE = 130.5 m²
KUFIRI I REPARTIT

000

437 250

437 500

SHKALLA 1:2500

VENDIM
Nr. 240, datë 27.3.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË TREGTIMIT DHE TË CERTIFIKIMIT TË
MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE TË FIDANËVE TË BIMËVE DRUFRUTORE¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 9 të nenit 4, të pikës 3 të nenit 14, të pikës 3 të nenit 15 dhe të pikës 4 të nenit 16 të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

I.1. Qëllimi dhe zbatimi

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore, për kategoritë, identitetin dhe cilësinë e tyre, rregullat e paketimit dhe të etiketimit, si dhe kriteret e procedurat e kryerjes së certifikimit.

2. Ky vendim zbatohet për gjinitë dhe speciet e listuara në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe për hibridet dhe nënshartesat e tyre.

I.2. Përkufizime

Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa me termat e mëposhtëm do të kuptohen:

1. “Bimë drufrutore”, gjinitë dhe speciet e kultivuara të pemëve frutore, të agrumeve dhe ullirit, të listuara në aneksin 1 të këtij vendimi, si dhe hibridet e nënshartesat e tyre.

2. “Klon”, pasardhësi vegjetativ i një bime të vetme, gjenetikisht i njëtrajtshëm.

3. “Materiale shumëzimi të bimëve drufrutore” janë:

a) farat për prodhim fidanësh direkt ose për prodhim filizash për nënshartesa;

b) filizat për nënshartesa dhe copat për nënshartesa për rrënjëzim;

c) fundakët, kamzat, lastunjat dhe kalemata për rrënjëzim për prodhim fidanësh direkt, pa shartim;

ç) kalemata për shartim dhe sythat për shartim, si mbishartesë, për fidanë të shartuar;

d) meristema rritjeje për shtim invitro për prodhim nënshartese ose dhe mbishartese.

4. “Fidanë frutorë”, bimët e reja drufrutore, të shartuara ose jo, të destinuara për mbjellje ose rimbjellje, pas tregtimit, që janë:

a) “fidanë frutorë të shartuar”, bimët e reja drufrutore të përfutuara nga bashkimi me shartim i dy materialeve të ndryshme të shumëzimit, njëri prej të cilëve ka formuar sistemin rrënjor dhe tjetri ka formuar trugun dhe kurorën;

b) “fidanë frutorë të pashartuar”, bimët e reja drufrutore të përfutuara nga një material shumëzimi, përjashtuar bashkimin me shartim.

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me direktivën e Këshillit 2008/90/EC të datës 29 shtator 2008, për tregtimin e materialeve të shumëzimit të bimëve frutore dhe fidanëve frutorë (CELEX nr. 32008L0090, Gazeta Zyrtare L 267, datë 8.10.2008), e ndryshuar së fundi nga direktiva e Komisionit 2010/777/EU e datës 15 dhjetor 2010 (CELEX nr. 32010D0777, Gazeta Zyrtare L 332, datë 16.12.2010, faqja 40) për shtyrjen e afatit në lidhje me kushtet e importit nga vendet e treta të materialeve të shumëzimit të bimëve frutore dhe fidanëve frutorë të destinuar për prodhimin e frutave.

Gjithashtu, është përafuar pjesërisht me direktivën e Komisionit 93/48/EEC të datës 23 qershor 1993, e cila vendos programin që përcakton kushtet që duhet të plotësojnë materialet e shumëzimit dhe fidanët frutorë të destinuar për prodhimin e frutave (CELEX nr. 31993L0048, Gazeta Zyrtare L 250, datë 7.10.1993, faqja 1-8) dhe direktivën e Komisionit 93/64, e datës 5 korrik 1993, që vendos masat zbatuese në lidhje me mbikëqyrjen dhe monitorimin e furnizuesve dhe mjediseve në përputhje me direktivën e Këshillit 92/34/EEC për tregtimin e materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore dhe fidanëve frutorë të destinuar për prodhimin e frutave (CELEX nr. 31993L0064, Gazeta Zyrtare L 250, datë 7.10.1993, faqja 33).



5. “Fidanë frutorë të kategorisë “të certifikuar””, fidanët që janë prodhuar nga shumëzimi në mënyrë vegjetative direkt nga materialet e shumëzimit të certifikuara, të prodhuara nga bimët mëmë të kategorisë së certifikuar.

6. “Kategori CAC ose Conformitas Agraria Communitatis = në përputhje me kërkesat e bujqësisë komunitare”, janë materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore, të cilat, nga mbikëqyrjet pamore të kryera gjatë procesit të prodhimit rezulton se janë të pastra nga organizmat e dëmshëm dhe sëmundjet e listuara në aneksin 2, plotësojnë kërkesat për identitetin, pastërtinë e species dhe atë varietore, si dhe plotësojnë kërkesat në lidhje me cilësinë e zhvillimit të tyre.

7. “Identitet varietor”, tërësia e veçorive botanike, morfologjike, biologjike dhe agroteknologjike që zotëron një varietet, vlera e të cilit është e njohur dhe plotëson qëllimet e përdorimit.

8. “Bllok mëmë”, plantacioni i mbjellë me bimë mëmë drufrutore, të cilat plotësojnë kërkesat për bimët prindërore dhe janë të certifikuara në kategorinë e certifikuar ose në kategorinë CAC.

9. “Fidanishte”, vendi i prodhimit të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

10. “Mjedise prodhimi”, blloqet e bimëve mëmë, ngastrat e tokës dhe gjithë infrastruktura tjetër ndihmëse për prodhimin e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore.

11. “Ngarkesë”, sasia, numri i materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore të një ose më shumë loteve që transportohen së bashku.

12. “Numri i referencës së lotit” ose “numri i referencës së ngarkesës”, çdo shenjë numerike, e cila bën të mundur që një lot ose ngarkesë të jetë e dallueshme dhe e gjurmueshme.

13. “Pastërti varietore dhe e species”, kërkesa për gjendjen e materialeve të shumëzimit pa përzierje të varieteteve dhe specieve që nuk janë deklaruar në dokumentacionin përkatës ose dhe nuk janë shënjuar si të tilla.

14. “Pastërti shëndetësore”, kërkesa për gjendjen e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore pa infeksione ose dhe pa simptoma të organizmave të dëmshëm dhe sëmundjeve të listuara në aneksin 2 të këtij vendimi dhe në legjislacionin për mbrojtjen e bimëve.

15. “Treguesit e cilësisë”, kërkesat që duhen plotësuar nga materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore në lidhje me cilësinë e zhvillimit të tyre, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

16. “Person përgjegjës i kualifikuar”, çdo person, fizik ose juridik, me profesion agronom me arsim të lartë, i specializuar për bimët drufrutore, në cilësinë e fuqizuesit ose i punësuar prej tij, që ka akt përfaqësimi nga furnizuesi për të vepruar në emër të tij për detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

II. KRITERET E TREGTIMIT TË MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE TË FIDANËVE TË BIMËVE DRUFRUTORE

II.1. Kërkesa të përgjithshme për vendosjen në treg

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore mund të tregtohen vetëm nëse:

- a) i përkasin njërës prej kategorive të përcaktuara në këtë vendim;
- b) materialet e shumëzimit janë certifikuar zyrtarisht si materiale të kategorive parabazë, bazë ose të certifikuar, ose janë certifikuar si materiale të kategorisë CAC;
- c) fidanët frutorë janë certifikuar zyrtarisht në kategorinë të certifikuar ose ata plotësojnë kushtet për t’u certifikuar në kategorinë CAC.

2. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutorë duhet t’u përkasin varieteteve ose, në rastin e nënshartesave, t’u përkasin specieve apo hibrideve ndërmjet specieve, të regjistruara në katalogun kombëtar.

3. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore duhet të plotësojnë kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e bimëve.

II.2. Kriteret për kategoritë

1. Kriter për përcaktimin e kategorisë për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore është prejardhja dhe shkalla e garancisë për identitetin dhe pastërtinë varietore, pastërtinë shëndetësore dhe treguesit e cilësisë.

2. Kategoritë e materialeve të shumëzimit janë:

a) Materiale shumëzimimi të certifikuara zyrtarisht, ku bëjnë pjesë kategoritë:

- i) parabazë;
- ii) bazë;
- iii) të certifikuar.

b) Materiale shumëzimimi të certifikuara, ku bën pjesë kategoria:

- i) CAC.

3. Kategoritë e fidanëve frutorë janë:

a) Fidanë frutorë të certifikuar zyrtarisht, ku bën pjesë kategoria:

- i) të certifikuar.
- b) Fidanë frutorë të certifikuar, ku bën pjesë kategoria:
- i) CAC.

4. Për materialet e shumëzimit të kategorive të certifikuara zyrtarisht si parabazë e bazë, pas kryerjes së procedurave të certifikimit, lëshohet certifikatë zyrtare, sipas modelit 7 të përcaktuar në aneksin 4 të këtij vendimi.

5. Për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore të certifikuara të kategorisë CAC dhe për fidanët frutore të kategorisë së certifikuar, lëshohet certifikatë zyrtare sipas modeleve 2 e 3 të aneksit 4 të këtij vendimi.

6. Kërkesat që duhet të plotësojnë materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore, sipas kategorive janë:

- a) të jenë përftuar sipas rregullave teknike;
- b) të sigurojnë ruajtjen e identitetit të varietetit dhe pastërtinë fitosanitare.

7. Rregullat teknike për kërkesat që duhet të plotësohen nga materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore, për kategorinë, për ruajtjen, identitetin dhe pastërtinë përcaktohen me udhëzim të ministrit.

II.3. Kriteret për identitetin varietor

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore tregtohen me emërtimin e varietetit, të cilit ata i përkasin. Në rastin e nënshartesave, kur materialet nuk i përkasin një varieteti, referenca për emërtimin do të bëhet për specien ose hibridin ndërmjet specieve të caktuara.

2. Varietetet për të cilët bëhet referenca duhet:

- a) të jenë regjistruar në katalogun kombëtar;
- b) t'u përkasin varieteteve, të cilët janë pranuar zyrtarisht për certifikim;
- c) në rastin e nënshartesave, të cilat nuk i përkasin ndonjë varieteti, të certifikohen zyrtarisht, të tregtohen me emërtimin për specie ose hibride ndërmjet specieve.

3. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore, për ruajtjen e identitetit dhe pastërtisë varietore, duhet të plotësojnë kërkesat në lidhje me gjurmueshmërinë, si më poshtë vijon:

a) materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore mbahen në lote të ndara, të shënuara e të etiketuara gjatë fazave të mëposhtme:

- i) rritjes në bllokun mëmë;
- ii) prerjes, marrjes, transportit e shpërndarjes nga blloku mëmë;
- iii) rritjes së bimëve të moshave kalimtare për prodhimin e fidanëve në të gjitha ngastrat e fidanishtes;

iv) vendosjeve, shkuljeve e lëvizjeve të ndryshme;

v) paketimit, ruajtjes, transportit dhe shpërndarjes.

b) nëse materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore të origjinave të ndryshme, gjatë paketimit, magazinimit, ruajtjes, transportit ose shpërndarjes janë vënë së bashku ose të përziera, furnizuesi duhet të mbajë të dhëna për përbërjen e bashkësisë ose të përzierjes, si dhe origjinën e përbërësve individuale të saj.

II. 4. Kriteret për cilësinë

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore të kategorisë CAC, duhet të plotësojnë kërkesat në lidhje me cilësinë e zhvillimit, si më poshtë vijon:

- a) të kenë formën dhe dimensionet përkatëse;



- b) të kenë vitalitet dhe organe të zhvilluara mirë;
- c) të jenë të padëmtuar e pa defekte që prishin cilësinë ose ulin vlerën e tyre për përdorim;
- ç) në rastin e fidanëve të shartuar, lidhja ndërmjet nënshartesës dhe mbishartesës në pikën e shartimit të jetë e fortë dhe pa ndonjë fryrje ose trashje.

2. Specifikimet teknike për cilësinë e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore të kategorisë CAC përcaktohen me urdhër të ministrit.

3. Në rastin e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore parabazë, bazë e të certifikuar, specifikimet teknike për cilësinë përcaktohen, sipas skemës së certifikimit, të miratuar me urdhër të ministrit.

II. 5. Kriteret për paketimin dhe etiketimin

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore tregtohen vetëm në ngarkesa ose lote homogjene dhe nëse ata janë:

a) të certifikuar në kategorinë CAC dhe të shoqëruara me etiketën e furnizuesit dhe certifikatën e origjinës;

b) të certifikuar dhe të etiketuara zyrtarisht për kategoritë parabazë, bazë ose të certifikuar e të shoqëruara me certifikatën e origjinës.

2. Kërkesat në lidhje me paketimin dhe etiketimin e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore përcaktohen në aneksin 3 të këtij vendimi.

3. Forma dhe përmbajtja e certifikatës së origjinës është sipas aneksit 5 të këtij vendimi.

III. KËRKESAT PËR CERTIFIKIMIN E MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE TË FIDANËVE TË BIMËVE DRUFRUTORE

III. 1. Kërkesa të përgjithshme për certifikim

1. Procedurat e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjekte publike apo private, sipas përcaktimit të kreun IX të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011 “Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor”.

2. Për kryerjen e procedurave të certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore, furnizuesi paraqet kërkesë pranë autoritetit certifikues, sipas rregullave të mëposhtme:

a) Kërkesa duhet të paraqitet deri në datën 30 prill të vitit kur fillon prodhimi i materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore, si dhe të përmbajë të dhënat për:

i) furnizuesin;

ii) aktivitetin që kryhet;

iii) materialet e shumëzimit ose/dhe fidanët e bimëve drufrutore;

iv) personin përgjegjës të kualifikuar.

b) Kërkesës i bashkëngjiten plani i prodhimit, dy kopje të modelit të etiketës sipas aneksit 3 të këtij vendimi dhe dy kopje të modelit të certifikatës së origjinës, të propozuara për miratim nga autoriteti certifikues. Forma, përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacioni që i bashkëngjitet asaj është sipas modelit 1 të aneksit 4 të këtij vendimi.

c) Shqyrtimi i kërkesës për certifikim duhet të përfundojë brenda 20 ditëve të paraqitjes së saj dhe autoriteti certifikues njofton zyrtarisht furnizuesit e pranuar ose jo, brenda 10 ditëve pas shqyrtimit.

ç) Kërkesa e furnizuesit për certifikim pranohet nëse:

i) përmbajtja e kërkesës dhe dokumentacioni bashkëlidhur, janë sipas kërkesave të përcaktuara në këtë vendim;

ii) materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore prodhohen, etiketohen dhe vendosen në treg nga persona përgjegjës të kualifikuar;

iii) materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore që kërkohen për certifikim i përkasin varieteteve ose, në rastin e nënshartesave, u përkasin specieve dhe hibrideve ndërmjet tyre që janë regjistruar në katalogun kombëtar;

iv) modeli i etiketës së propozuar nga furnizuesi është në përputhje me kërkesat e këtij vendimi dhe sipas përcaktimit të aneksit 3 të tij, ndërsa modeli i certifikatës së origjinës është sipas përcaktimit të aneksit 5 të këtij vendimi.

III.2. Kërkesat për certifikimin e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore CAC

1. Kërkesat që duhet të përmbushë blloku mëmë për certifikimin në kategorinë CAC janë si më poshtë:

a) ngritja e bllokut mëmë të jetë realizuar sipas një projekti paraprak, të hartuar sipas rregullave teknike të miratuara me udhëzim të ministrit;

b) toka të sigurojë pastërtinë nga organizmat e dëmshëm dhe sëmundjet e listuara sipas specieve në aneksin 2 të këtij vendimi, dhe që vërtetohet me fletanalizë laboratorike të kryer nga shërbimi fitosanitar;

c) bimët e mbjella të jenë përftuar nga materiale shumëzimi, vizualisht të pastra nga ana varietore dhe shëndetësore, me origjinë të njohur e të dokumentuar, të vërtetuar me certifikatën fitosanitare dhe certifikatën zyrtare;

ç) bimët e mbjella të jenë shënjuar qartë, për çdo specie e varietet, në përputhje me emërtimet e dhëna në skemën e mbjelljes, të ruajtur në dosjen e bllokut mëmë;

d) të jenë kryer të gjitha praktikat e nevojshme për mirëmbajtjen e bllokut;

dh) furnizuesi të mbajë dokumentacionin e nevojshëm sipas rregullave teknike të miratuara me udhëzim të ministrit.

2. Kërkesat që duhet të përmbushë fidanishtja e prodhimit të fidanëve frutorë për certifikimin në kategorinë CAC janë, si më poshtë vijon:

a) fidanët frutorë të prodhohen nga materiale shumëzimi, të përftuara nga blloku mëmë i certifikuar në kategorinë CAC dhe, në rastin e fidanëve frutorë të shartuar, nënshartesa të jetë përftuar nga blloku mëmë, i certifikuar zyrtarisht në kategorinë bazë ose të certifikuar e që vërtetohet me certifikatën fitosanitare dhe certifikatën zyrtare;

b) ngritja e fidanishtes të jetë realizuar sipas një projekti paraprak, të hartuar sipas rregullave teknike të miratuara me udhëzim të ministrit;

c) toka të sigurojë pastërtinë nga organizmat e dëmshëm dhe sëmundjet e që vërtetohet me fletanalizë laboratorike të kryer nga shërbimi fitosanitar;

ç) materialet e shumëzimit, për të siguruar pastërtinë e varieteteve apo të kombinimeve varietet e nënshartesë, të mbillen të ndara e të shënjuara, sipas rregullave teknike të miratuara me udhëzim të ministrit;

d) furnizuesi të mbajë dokumentacionin e nevojshëm, sipas rregullave teknike të miratuara me udhëzim të ministrit.

IV. PROCEDURAT E CERTIFIKIMIT TË MATERIALEVE TË SHUMËZIMIT DHE TË FIDANËVE TË BIMËVE DRUFRUTORE

IV.1 Procedurat e certifikimit, rregulla të përgjithshme

1. Autoriteti certifikues kryen mbikëqyrje periodike të procesit të prodhimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore në mënyrë që të sigurohet në vijimësi përputhja me kërkesat e përcaktuara për certifikimin.

2. Në përfundim të çdo mbikëqyrjeje nga ana e autoritetit certifikues mbahet aktverifikimi, sipas modelit që i bashkëngjitet certifikatës zyrtare të përcaktuar në aneksin 4 të këtij vendimi.

3. Përmbajtja e kërkesës për certifikim, modeli i certifikatës zyrtare dhe i aktverifikimeve që i bashkëngjiten certifikatës zyrtare, për materialet e shumëzimit të kategorive parabazë dhe bazë, përcaktohen në modelet 6, 7 dhe 7/1 të aneksit 4 të këtij vendimi.

IV.2 Procedurat për certifikimin e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore të kategorisë CAC

IV.2.1 Procedurat për certifikimin e bllokut mëmë dhe autorizimin e prerjes ose dhe të marrjes së materialeve të shumëzimit të kategorisë CAC

1. Në bazë të kërkesës së furnizuesit për certifikim, autoriteti certifikues, brenda 30 qershorit, kryen procedurat për certifikimin e bllokut të bimëve mëmë, si më poshtë vijon:

a) shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga furnizuesi në lidhje me kërkesat që duhet të plotësojë blloku i bimëve mëmë për sigurinë e pastërtisë varietore dhe shëndetësore;



b) kryen në vend mbikëqyrjen vizuale, lidhur me pastërtinë varietore e shëndetësore;

c) nëse nga dokumentacioni i paraqitur nga furnizuesi, nga mbikëqyrja vizuale dhe nga aktverifikimet e mbajtura në vend, vërtetohet se blloku mëmë plotëson kërkesat e përcaktuara për certifikim, autoriteti certifikues, i lëshon furnizuesit certifikatën zyrtare për bllokun mëmë CAC, sipas modelit 2 të aneksit 4 të këtij vendimi;

ç) mbështetur në aktverifikimet e bllokut të bimëve mëmë, sipas modelit 2/1 të aneksit 4, autoriteti certifikues, të paktën, një muaj para prerjes, marrjes dhe lëvizjes së materialeve të shumëzimit, autorizon furnizuesin për nxjerrjen e etiketës dhe të certifikatës së origjinës. Përmbajtja e autorizimit është sipas modelit 4 të aneksit 4 të këtij vendimi.

2. Gjatë paketimit dhe vendosjes së etiketave, furnizuesi mbikëqyret nga autoriteti certifikues, i cili vërteton sasinë përfundimtare të materialeve të shumëzimit, plotësimin e kërkesave të cilësisë, paketimin dhe etiketimin, si dhe numrin e etiketave të lëshuara nga furnizuesi.

IV.2.2 Procedurat për certifikimin e fidanishtes dhe autorizimin e lëshimit të etiketave për materialet e shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore të kategorisë CAC

1. Furnizuesi që prodhon, për tregtim, fidanë frutorë të kategorisë CAC, lejohet t'i tregtojë ato, pasi të jenë certifikuar nga autoriteti certifikues dhe të ketë marrë autorizim për nxjerrjen e etiketave të tij.

2. Pas deklaramentit të prodhimit të parashikuar vjetor të fidanëve, në kërkesën për certifikim, autoriteti certifikues, gjatë muajve shtator e tetor, kryen procedurat për certifikim, si më poshtë vijon:

a) kryen mbikëqyrje dhe mban aktverifikime, sipas formularëve të përcaktuar në aneksin 4 të këtij vendimi, nëse furnizuesi plotëson detyrimet e përcaktuara përmbajtjen e të dhënave si më poshtë:

i) për provat mbi materialet e shumëzimit të përdorura për prodhim fidanësh ose, sipas rastit, të përdorura për shartim, në lidhje me origjinën e tyre, për pastërtinë varietore dhe shëndetësore;

ii) për tokën e fidanishtes;

iii) mbi masat e marra, për parandalimin e shfaqjes e përhapjes së organizmave të dëmshëm dhe sëmundjeve, si dhe masat e tjera, kryesisht largimin e bimëve ose të materialeve të shumëzimit apo shkatërrimin e tyre;

iv) për masat e marra në fidanishte, për ruajtjen e pastërtisë varietore;

v) për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve frutore që plotësojnë kërkesat për shkulje ose zhvendosjen për përgatitjen e tyre për tregtim.

3. Në bazë të të dhënave nga mbikëqyrjet e kryera dhe nga aktverifikimet e mbajtura në vend sipas modelit 3/1, autoriteti certifikues i lëshon furnizuesit certifikatën zyrtare për fidanishten e kategorisë CAC, sipas modelit 3 të aneksit 4 të këtij vendimi.

4. Nëse vërtetohet se materialet e shumëzimit, që janë përdorur për prodhimin e fidanëve, plotësojnë kërkesat edhe gjatë rritjes, autoriteti certifikues, jo më pak se dy muaj para shkuljes ose lëvizjes së fidanëve për tregtim, autorizon furnizuesin për nxjerrjen e etiketës dhe të certifikatës së origjinës. Përmbajtja e autorizimit është sipas modelit 5 të aneksit 4 të këtij vendimi.

5. Gjatë paketimit dhe vendosjes së etiketave, furnizuesi mbikëqyret nga autoriteti certifikues, i cili vërteton sasinë përfundimtare të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve frutorë të prodhuar në fidanishte, plotësimin e kërkesave të cilësisë, paketimin dhe etiketimin, si dhe numrin e etiketave të lëshuara nga furnizuesi.

IV.3. Kërkesat dhe procedurat për certifikimin zyrtar të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore parabazë, bazë dhe të certifikuar

1. Kërkesat e përgjithshme janë si më poshtë:

a) materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore, pranohen për kryerjen e procedurave për certifikim zyrtar nëse:

i) rrjedhin nga materiale shumëzimi, që janë përftuar në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara;

ii) u takojnë varieteteve që janë regjistruar në katalogun kombëtar ose që janë në proces pranimi për regjistrim në katalogun kombëtar.

2. Kërkesat specifike për certifikimin zyrtar të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve frutorë, sipas kategorive janë, si më poshtë:

- a) për bimët mëmë parabazë, metodat dhe procedurat e përfimit dhe e mirëmbajtjes së tyre;
- b) për bimët mëmë bazë, përfimi dhe mirëmbajtja e tyre;
- c) për bllokun e bimëve mëmë të certifikuara, përfimi dhe metodat e rritjes e të mirëmbajtjes;
- ç) për fidanishten e prodhimit të fidanëve të certifikuar dhe për nënshartesa të certifikuara, metodat e prodhimit dhe praktikat e mira të rritjes.

3. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore të certifikuar zyrtarisht dhe të importuara nga vendet e BE-së, mund të përdoren e mirëmbahen si material bazë ose dhe si bimë mëmë për ngritjen e bllokut mëmë të kategorisë i certifikuar.

4. Rregullat teknike për prodhimin dhe certifikimin zyrtar të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve drufrutore, sipas kategorive të mësipërme, miratohen me udhëzim të ministrit, sipas grup-specieve të bimëve drufrutore të mëposhtme:

- a) drufrutorët farorë si: molla, dardha dhe ftoi;
- b) drufrutorët bërthamorë, speciet e bimëve frutore të gjinisë *Prunus L.*, si: qershia, vishnja, pjeshka e pjeshka nektarinë, kumbulla gjatore, kumbulla kino-japoneze, kajsia dhe bajamja.

V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore që deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi janë prodhuar në përputhje me legjislacionin e mëparshëm, do të konsiderohen se plotësojnë kërkesat sipas këtij vendimi.

2. Deri në vitin 2018, fidanprodhuesit individualë ose të bashkuar, duhet të ngrenë blloqet e bimëve mëmë të kategorisë CAC.

3. Përjashtimisht nga përcaktimet e bëra në këtë vendim, deri në shkurt të vitit 2019, lejohet marrja e materialeve të shumëzimit për mbishartesa dhe për nënshartesa nga bimë drufrutore ekzistuese të përzgjedhura e të shënuara në blloqet e prodhimit, në koleksione ose bimë të veçanta, me kusht që të plotësojnë kërkesat njëloj, si për bllokun mëmë të kategorisë CAC në lidhje me identitetin dhe pastërtinë varietore e shëndetësore dhe të jenë certifikuar nga autoriteti certifikues.

4. Procedurat për certifikimin e materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve frutorë të kategorisë CAC fillojnë në prill 2014.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



Aneks 1

Lista e gjinive dhe specieve për të cilat zbatohet ky vendim

Actinidia (A.Chev.)	Kivi
Castanea sativa Mill.	Gështenja
Citrus L.	Agrumet
Cornus mas L.	Thana
Corylus avellana L.	Lajthia
Cydonia oblonga Mill.	Ftoi
Eriobotrya japonica	Nespola
Ficus carica L.	Fiku
Fortunella Sëingle	Kumquat
Fragaria L.	Luleshtrydhja
Juglans regia L.	Arra
Malus Mill.	Molla
Mespilus germanica	Mushmolla dimërore
Morus sp	Mani
Olea europaea L.	Ulliri
Pistacia vera L.	Pistaku
Poncirus Raf.	Trifoljata
Prunus amygdalus Batsch	Bajamja
Prunus L. Armeniaca	Kajsia
Prunus avium (L.) L.	Qershia
Prunus cerasus L.	Vishnja
Prunus domestica L.	Kumbulla gjatore
Prunus persica (L.) Batsch	Pjeshka (dhe Nektarina)
Prunus salicina Lindley	Kumbulla kino-japoneze
Punica granatum	Shega
Pyrus L.	Dardha
Ribes L.	Rrush frëngu
Rubus L.	Mjedhra
Vaccinium L.	Boronica
Zizyphus Zizyphus	Hidja (xinxife)

Aneks 2

Lista e organizmave të dëmshme dhe sëmundjeve të rëndësishme që prekin cilësinë e materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore dhe fidanëve frutorë

Gjinia ose specia	Organizmat e dëmshme dhe sëmundjet specifike
- Citrus aurantifolia(Christm)Swing. - <i>Limeta</i> - Citrus Limon L. Burm. F - <i>Limoni</i> - Citrus paradisi Macf - <i>Greipfruti</i> - Citrus reticulata Blanco - <i>Mandarina</i> - Citrus sinensis (L.) Osbeck - <i>Portokalli i ëmbël</i>	Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Aleurothrixus floccosus (Mashell) - Meloidogyne spp. - Parabemisia myricae (Kuwana) - Tylenchulus semipenetrans Sëmundjet kërpudhore - Phytophthora spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Citrus leaf rugose - Diseases that induce psorosis-like young leaves symptoms such as: psorosis, ring spot, cristicortis, impietratura, concave gum - Infectious variegation - Viroids such as exocortis, cachexiaxyloporosis Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Epidiaspis leperii - Eriophis avellanae - Pseudaulacaspis pentagona - Quadraspidiotus perniciosus Bakteriet - Agrobacterium tumefaciens - Xanthomonas campestris pv. corylina Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Chondrostereum purpureum - Nectria galligena - Phyllactinia guttata - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Apple mosaic virus - Hazel maculatura lineare MLO Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Anarsia lineatella
- Corylus avellana - <i>Lajthia</i>	
- Cydonia Miller communis L. - <i>Dardha</i> - <i>Ftoi- Pyrus</i>	



Gjinia ose specia	Organizmat e dëmshme dhe sëmundjet specifike
	- Eriosoma lanigerum - Scale insects, in particular: Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus=Bakteriet - Agrobacterium tumefaciens - Pseudomonas syringae pv. syringae Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Chondrostereum purpureum - Nectria galligena - Phytophthora spp. - Rosellinia necatrix - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset: të gjithë
- Fragaria x ananassa duch - Luleshtrydhja ose dredhëza	Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Aphelenchoides spp. - Ditylenchus dipsaci - Tarsonemidae Sëmundjet kërpudhore - Phytophthora cactorum - Verticillium spp. Viruses and virus-like organisms, and in particular - Strawberry green petal MLO
- Juglans regia L. - Arra	Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Scale insects, in particular: Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus Bacteria - Agrobacterium tumefaciens - Xanthomonas campestris pv. Juglandi Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Nectria galligena - Chondrostereum purpureum - Phytophthora spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Cheery leaf roll virus
- Malus Miller - gjinia e mollës	Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre
Gjinia ose Specia	Organizmat e dëmshme dhe sëmundjet specifike

	- Anarsia lineatella - Eriosoma lanigerum - Scale insects, in particular Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus Bakteriet - Agrobacterium tumefaciens - Pseudomonas syringae pv. syringae Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Chondrostereum purpureum - Nectria galligena - Phytophthora cactorum - Rosellinia necatrix - Venturia spp. - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset: të gjithë Insektet, akariat dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Eusophora pinguis - Meloidogyne spp. - Saissetia oleae Bakteriet - Pseudomonas syringae pv. savastanoi Sëmundjet kërpudhore - Verticillium dahliae Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset: të gjithë Sëmundjet kërpudhore - Verticillium spp. Viruses and virus-like organisms të gjithë Insektet, akariat dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Aculops fockeui - Capnodis tenebrionis - Eriophyes similis - Meloidogyne spp. - Scale insects, in particular: Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus Bakteriet - Agrobacterium tumefaciens
Gjinia ose Specia	Organizmat e dëmshme dhe sëmundjet specifike
	- Pseudomonas syringae pv. mors prunorum - Pseudomonas syringae pv. syringae

- Prunus armeniaca (L.) - Kajsia - Prunus amygdalus Batsch - Bajamja - Prunus persica (L.) Batsch - Pjeshka(dhe nektarina)	Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Chondrostereum purpureum - Nectria galligena - Rosellinia necatrix - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Plum pox virus - Prune dwarf virus - Prunus necrotic ringspot virus Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Anarsia lineatella - Capnodis tenebrionis - Meloidogyne spp. - Scale insects, in particular: Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus Bakteriet - Agrobacterium tumefaciens - Pseudomonas syringae pv. mors prunorum - Pseudomonas syringae pv. syringae
- Prunus avium L. - qershia - Prunus cerasus - vishnja	Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Chondrostereum purpureum - Nectria galligena - Rosellinia necatrix - Taphrina defortnans - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Plum pox virus - Prune dwarf virus - Prunus necrotic ringspot virus Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Capnodis tenebrionis - Meloidogyne spp. - Scale insects, in particular: Epidiaspis leperii, Pseudaulacaspis pentagona, Quadraspidiotus perniciosus Bakteriet - Agrobacterium tumefaciens - Pseudomonas syringae pv. mors prunorum - Pseudomonas syringae pv. Syringae
Gjinia ose Specia	Organizmat e dëmshme dhe sëmundjet specifike

- Ribes	- Ribes ose rrush frengu	Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Chondrostereum purpureum - Nectria galligena - Rosellinia necatrix - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Plum pox virus - Prune dwarf virus - Prunus necrotic ringspot virus Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Aphelenchoides spp. - Cecidophyopsis ribis Bakteriet Agrobacterium tumefaciens Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Nectria cinnabarina - Rosellinia necatrix - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Black currant reversion - Black currant infectious variegation agent
- Rubus	- Mjedhra (manaferra)	Insektet, akariet dhe nematodat për të gjitha fazat e zhvillimit të tyre - Aceria essigi Bakteriet - Agrobacterium rhizogenes - Agrobacterium tumefaciens - Rhodococcus fascians Sëmundjet kërpudhore - Armillariella mellea - Didymelia applanata - Peronospora rubi - Phytophthora fragariae var. rubi - Verticillium spp. Viruset dhe organizmat e tjera të ngjashme me viruset dhe në veçanti: - Raspberry bushy dwarf virus - Raspberry leaf curl virus



Aneksi 3

Kërkesat për paketimin dhe etiketimin

1. Materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore të kategorisë CAC paketojnë dhe etiketohen nga furnizuesi me paketa për një copë të vetme ose për më shumë copë së bashku me kusht që:

- a) të sigurohet origjinaliteti i paketimit dhe etiketimit,
- b) paketimi nuk mund të hapet pa lënë shenja të ngacmimit në etiketën ose në paketimin,
- c) materiali paketues duhet të jetë me cilësi të tillë që të mbrojë materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore nga dehidratimi, nga temperaturat e ulëta dhe nga dëmtimet e tjera që mund të ndodhin gjatë transportit ose gjatë lëvizjeve me dorë.

2. Etiketat e furnizuesit të lëshuara për materialet e shumëzimit dhe fidanët frutorë duhet të jenë nga material i qendrueshëm ndaj agjenteve atmosferike dhe i papërdorur si dhe të shtypet në gjuhën shqipe ose, në rastet e importit, të jetë në njërën nga gjuhët zyrtare të BE-së.

3. Informacioni i detyrueshëm që përmban etiketa e furnizuesit për kategorinë CAC është si vijon:

- Cilësia KE: (në rastin e importeve nga vendet e tjera)
- Shteti: (emri i shtetit, RSh për prodhimin vendas)
- Struktura përgjegjëse për çertifikimin: (emërtimi i strukturës së caktuar nga ligji)
- Furnizuesi: (emri i furnizuesit dhe adresa)
- Kodi i regjistrimit të furnizuesit: (numri)
- Loti ose lotet ose ngarkesa: (numri ose numrat referues të tyre ose serisë)
- Data e nxjerrjes së etiketës së furnizuesit:
- Lloji: (emërtimi i materialit shumëzues apo i fidanit të bimëve drufrutore, i shartuar ose i pashartuar)
- Specia: (emri botanik)
- Varieteti: (emri i varietetit)
- Nënshartesa: (sipas rastit: emri i varietetit, hibridit apo kodi i saj bazë)
- Sasia:
- Kategoria: CAC
- Vendi i prodhimit: (emri i shtetit në rastin e importeve nga vendet e tjera)

4. Nëse materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore shoqërohen me një pasaportë bimore në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin për mbrojtjen e bimëve, pasaporta bimore do të konsiderohet si një etiketë ose një dokument i furnizuesit, me kusht që furnizuesi duhet të japë informacionin e mëposhtëm shtesë, i cili mund të jetë dokument i njëjtë me pasaportën bimore, por i ndarë në mënyrë të qartë nga të dhënat e tjera:

- Cilësia KE: (në rastin e importeve nga vendet e tjera)
- Struktura përgjegjëse zyrtare për pasaportat bimore: (emërtimi i strukturës së caktuar nga ligji)
- Varieteti: (emri i varietetit)
- Kategoria: CAC
- Vendi i prodhimit: (emri i shtetit në rastin e importeve nga vendet e tjera)

5. Informacioni që përmban etiketa zyrtare e lëshuar nga autoriteti certifikues për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore të certifikuara të kategorive parabazë, bazë ose të çertifikuara, është si vijon:

- Cilësia KE: (në rastin e importeve nga vendet e tjera)
- Shteti: (emri i shtetit, RSh për prodhimin vendas)
- Struktura përgjegjëse për çertifikimin: (emërtimi i strukturës së caktuar nga ligji)
- Loti ose lotet ose ngarkesa: (numri ose numrat referues të tyre ose serisë)
- Lloji: (emërtimi i materialit shumëzues apo i fidanit frutor i shartuar ose i pashartuar)
- Specia: (emri botanik)
- Varieteti: (emri i varietetit)

- Nënshartesa: (sipas rastit: emri i varietetit, hibridit apo kodi i saj bazë)
- Sasia:
- Kategoria: (që mund të jetë parabazë, bazë ose të certifikuara)
- Vendi i prodhimit: (emri i shtetit, në rastin e importeve nga vendet e tjera)
- Gjendja shëndetësore: (në përputhje me gjendjen shëndetësore, në etiketën zyrtare jepen të dhëna si: "pa viruse" ("p.v.") ose "kontrolluar për viruse" ("k.v.")).

6. Certifikata e origjinës (e furnizuesit), që tregon origjinën e materialeve të shumëzimit ose dhe të fidanëve frutorë, përveç informacionit që përmban etiketa e furnizuesit, përmban edhe:

- Sasia totale : (Sasia e llojit apo llojeve të materialeve të shumëzimit apo fidanëve frutorë sipas kategorive, sipas varieteteve, në një lot, në një ngarkesë ose në një dërgesë).

Certifikata e origjinës plotësohet dhe për materialet e shumëzimit të prodhuara për nevojat e vetë furnizuesit dhe i bashkëngjitet të dhënave të regjistruara nga furnizuesi për origjinën e materialeve të shumëzimit.

7. Ngjyra e etiketave sipas kategorive është si vijon:

- a) etiketa e furnizuesit për kategorinë CAC me ngjyrë bardhë,
- b) etiketa zyrtare për kategoritë:
 - i. para-bazë me ngjyrë të bardhë me një shirit diagonal ngjyrë violet,
 - ii. bazë me ngjyrë të bardhë,
 - iii. të certifikuar me ngjyrë blu,

8. Gjatë tregtimit, transportit, shpërndarjes dhe shitjes te përdoruesi final, materialet e shumëzimit dhe/ose fidanët e bimëve drufrutore shoqërohen me dokument shoqërues në përputhje me kërkesat e legjislacionit tatimor.

Aneksi 4

Dokumentat për certifikim

Model 1

KËRKESE PËR CERTIFIKIM

të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore të kategorive CAC dhe I Certifikuar

Drejtuar: _____ (Autoritetit Certifikues))

I nënshkruari _____, në cilësinë e furnizuesit për : prodhimin ☐

prodhimin dhe tregtimin□

përgatitjen për treg dhe tregtimin □

e materialeve të shumëzimit dhe ose fidanëve të bimëve drufrutore, kërkoj aprovimin e bllokut të bimëve
mëmë të kategorisë _____ ose dhe të fidanishtes të kategorisë _____, për prerjen, marjen,
shkuljen dhe lëvizjen e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore si vijon:

a) Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri e mbiemri : _____, Emërtimi i Subjektit(Firmës) _____
 2. Adresa: e vendbanimit _____, e Zyres _____
 3. Vendodhja e aktivitetit: _____
 4. Kodi i furnizuesit: _____, 5. Numri i licences: _____

b) Të dhëna për personin përgjegjës të kualifikuar:

1. Emri e mbiemri : _____
2. Adresa: e vendbanimit _____, e Zyrës _____
3. Arsimi: _____
4. Specializimi: _____

c) Të dhëna për bllokun e bimëve mëmë për certifikim dhe parashikimi i prodhimit të materialeve të shumëzimit:

[illegible]

d) Të dhëna për fidanishten

Nr	speciet, varietetet dhe ose, për nënshartesat, filizat sipas specieve dhe hibridet ndërmjet specieve.	Sipërfaqja gjithsej m ²	Nga kjo:		Parashikimi i prodhimit për tregtim, për vitin në vijim, rrënjë			
			Për nënshartesa (farishte, vijë fidanishte, , copa për rrënjëzim etj) m ²	Për fidanë (nga shartesat etj deri tek fidanët për shkullje)	Fidanë frutorë	Materiale shumëzimi		
	Gjithsej							
1.	Specia.....							
	Varieteti.....							

Bashkëngjitur kërkesës së përmendur më sipër është plani i prodhimit me përmbajtje si vijon:

(i) në rastin e bllokut mëmë: planvendosja e bllokut mëmë me të gjitha të dhënat e detajuara në skemën e mbjelljes për speciet, varietetet dhe në rastin e nënshartesave, për hibridet ndërmjet specieve, si dhe origjina e tyre;

(ii) në rastin e prodhimit të fidanëve: një dokument në lidhje me çdo fushë të fidanishtes, i cili të përmbajë:

- kopje të hartës së regjistratit të tokës ku tregohet blloku i bimëve mëmë ose dhe fidanishtja me të gjitha fushat dhe mjediset e saj;
- skemën e ngritjes së bllokut mëmë ose dhe planin e mbjelljes të fidanishtes (sipas specieve dhe kombinimeve të shartuara, varieteti i mbishartesës dhe nënshartesës);
- të dhënat për metodat e prodhimit të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore , për materialet e shumëzimit të përdorura për prodhimin e fidanëve frutorë dhe regjistrat e ekzaminimeve të kryera dhe masat e zbatuara, duke patur parasysh, në veçanti, kontrollin dhe mbikëqyrjen e organizmave të dëmshme e të sëmundjeve;
- të dhënat mbi përshtatshmërinë e tokës për çdo fushë të fidanishtes.

(iii) në lidhje me etiketat: dy kopje të modelit të etiketës zyrtare që furnizuesi propozon të lëshojë për materialet e shumëzimit dhe fidanët e bimëve drufrutore të kategorisë CAC ;

Shënim: deklaroj se jam i informuar për detyrimet e furnizuesit që lëshon etiketat e furnizuesit, në përputhje me ligjin për materialin mbjellës dhe me këtë vendim.

Kërkuesi

(emri e mbiemri i furnizuesit ose përfaqësuesit të tij)

firma e vula

_____, më _____ 201_

E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.

Aneks 4

Model 2

Autoriteti Certifikues _____

Nr. i serisë _____



CERTIFIKATË ZYRTARE

për bllokun mëmë të kategorisë CAC ose i Certifikuar

Lëshuar furnizuesit: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i subjektit) _____,
Adresa: e vendbanimit _____
Vendodhja e aktivitetit: _____
Kodi i furnizuesit: _____

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer nga autoriteti certifikues me datë _____,
sipas ligjit Nr.10416, datë 07.04.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, pasi është
konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

Certifikon në kategorinë _____ bllokun mëmë që vijon:

a) blloku i bimëve mëmë është ngritur në ngastrën me nr. pasurie _____, në zonën kadastrale
nr. _____, në vendin e quajtur _____, Fshati _____
,Komuna _____, Rrethi _____ Qarku _____, me sipërfaqe _____m2 dhe me
_____rrënjë bimë mëmë gjithsej.

Të dhënat për mbjelljen e bllokut mëmë sipas specieve, varieteteve dhe, për nënshartesat, dhe hibrideve
ndërmjet specieve, janë si vijon:

Nr	Speciet, varietetet dhe ose, për nënshartesat, hibridet ndërmjet specieve.	Sipërfa qja m2	Numri i bimëve gjithsej rrënjë	Sipas destinacionit, rrënjë							
				Për sytha për sharti m	Për kalema për shartim	Për kalem a për rrënjëz im	Për Fun- dakë Copë	Për Kamz a për rrënjë zim	Për Last unja	Për Fara	Për Copa për rrënjëzim
	Gjithsej										
1.	Specia.....										
	Varieteti.....										

Bashkëngjitur janë akt-verifikimet e plotësuar nga personi i ngarkuar nga autoriteti i certifikimit për të
mbikëqyrur plotësimin e kërkesave për certifikimin e bllokut të bimëve mëmë i kërkuar për certifikim nga
furnizuesi.

Certifikuesi

emri, mbiemri e firma
vula

Lëshuar më _____ 201__
E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.

Aneks 4

Autoriteti Certifikues _____

Model 2/1

Akt – verifikim

Për plotësimin e kërkesave për certifikim të bllokut mëmë të kategorisë _____

Nga verifikimi i kryer për gjendjen në terren dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit përkatës të mbajtur më datë _____ rezulton si vijon:

Nr	Kërkesat që duhet të plotësohen për t'u certifikuar në Kategorinë _____	Plotësuar Po ose Jo	Në se Jo: Afati (nëse është e mundur) kur duhet të plotësohet	Vërejtje

Si përfundim: _____

(këtu personi i ngarkuar nga autoriteti certifikues jep opinionin personal lidhur me plotësimin ose jo të kërkesave për certifikim)

Personi i ngarkuar nga Autoriteti i Certifikimit

Furnizuesi

(emri e mbiemri, firma)

(emri e mbiemri, firma)

Aneks 4

Model 3

Autoriteti Certifikues _____



Nr. i serisë _____

CERTIFIKATË ZYRTARE

për fidanishten e kategorisë CAC ose e Certifikuar

Lëshuar furnizuesit: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i bjehtit) _____

Adresa: e vendbanimit _____,
vendodhja e aktivitetit: _____
kodi i furnizuesit: _____

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer nga autoriteti certifikues me datë _____,
sipas ligjit Nr.10416, datë 07.04.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, pasi është
konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

Certifikon në kategorinë _____ fidanishten që vijon:

a) fidanishtja e materialeve të shumëzimit dhe fidanëve frutorë është ngritur në ngastrat me nr. pasurie
_____, në zonën kadastrale nr. _____, në vendin e quajtur _____,
Fshati _____, Komuna _____, Rrethi _____ Qarku _____, me
sipërfaqe _____ m².
Të dhëna për fidanishten

Nr	Speciet, varietetet dhe ose, për nënshartesat, filizat sipas specieve dhe hibridet ndërmjet specieve.	Sipërfaqja gjithsej m ²	Nga kjo:		Fidanë frutorë	Parashikohet të prodhohen për tregtim, për vitin në vijim, rrënjë			
			Për nënshartesat (farishte, vijë fidanishte, , copa për rrënjëzim etj) m ²	Për fidanë (nga shartesat etj deri tek fidanët per shkullje) m ²		Materiale shumëzimi			
	Gjithsej								
I.	Specia.....								
	Varietetet.....								

Bashkëngjitur janë akt-verifikimet e plotësuar nga personi i ngarkuar nga autoriteti i certifikimit për të mbikëqyrur plotësimin e kërkesave për certifikimin e materialeve të shumëzimit ose dhe fidanëve frutorë të kërkuar për certifikim nga furnizuesi.

Certifikuesi

emri, mbiemri e firma
vula

Lëshuar më _____ 201_
E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.

Aneks 4

Model 3/1

Autoriteti Certifikues _____

Akt – verifikim

Për plotësimin e kërkesave për certifikim të fidanishtes së kategorisë _____

Nga verifikimi i kryer për gjendjen në terren dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit përkatës të mbajtur më datë _____ rezultojn si vijon:

Nr	Kërkesat që duhet të plotësohen për t'u certifikuar në Kategorinë _____	Plotësuar Po ose Jo	Në se Jo: Afati (nëse është e mundur) kur duhet të plotësohet	Vërejtje

Si përfundim: _____

(këtu personi i ngarkuar nga autoriteti certifikues jep opinionin personal lidhur me plotësimin ose jo të kërkesave për certifikim)

Personi i ngarkuar nga Autoriteti i Certifikimit

Furnizuesi

(emri e mbiemri, firma)

(emri e mbiemri, firma)

_____, më _____

Aneks 4

Model 4

Autoriteti Certifikues _____

Nr. i serisë _____



AUTORIZIM

për nxjerrjen e etiketave të furnizuesit dhe certifikatën e origjinës për
materialet e shumëzimit të kategorisë CAC ose i Certifikuar

Lëshuar furnizuesit: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i bjektit) _____
Adresa e vendbanimit: _____,
Vendodhja e aktivitetit: _____
Kodi i furnizuesit: _____.

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer nga autoriteti certifikues, sipas ligjit Nr.10416, datë 07.04.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, në certifikatën zyrtare të bllokut mëmë të kategorisë _____ me nr. serie _____, lëshuar më _____ 201__ dhe në certifikatën zyrtare të fidanishtes të kategorisë _____ me nr. serie _____, lëshuar më _____ 201__, pasi është konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

A u t o r i z o j furnizuesin,

1. Për nxjerrjen e etiketave të furnizuesit për materialet e shumëzimit dhe certifikatave të origjinës që vijojnë:
2. Sasia dhe numri serial i etiketave që autorizohen janë si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi i llojeve të materialeve të shumëzimit sipas specieve	Varieteti ose sipas rastit për nënshartesat hibridi	Sasia e prodhuar gjithsej cope	Numri i Lotit	Etiketat	
					Gjithsej cope	Nr i serial nga _____ deri _____

Bashkëngjitur këtij autorizimi janë modelet e miratuara të etiketës së furnizuesit dhe certifikatës së origjinës për materialet e shumëzimit.

Certifikuesi

emri, mbiemri e firma
vula

Lëshuar më _____ 201__
E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.

Aneks 4

Model 5

Autoriteti Certifikues _____

Nr. i serisë _____

AUTORIZIM

për nxjerrjen e etiketave të furnizuesit
për fidanët frutorë e CAC

Lëshuar furnizuesit: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i bjektit) _____

Adresa: e vendbanimit: _____,

Vendodhja e aktivitetit: _____

Kodi i furnizuesit: _____.

Bazuar në mbikëqyrjen e kryer nga autoriteti certifikues, sipas ligjit Nr.10416, datë 07.04.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, në certifikatën zyrtare të fidanishtes të kategorisë CAC me nr. serie _____, lëshuar më _____ 201_, pasi është konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

A u t o r i z o j furnizuesin,

1. Për nxjerrjen e etiketave të furnizuesit për fidanët frutorë dhe certifikatave të origjinës që vijojnë:
2. Sasia dhe numri serial i etiketave që autorizohen janë si më poshtë vijon:

Nr	Emërtimi i specieve të fidanëve frutorë	Varieteti	Sasia e prodhuar gjithsej fidanë	Numri i Lotit	Etiketat	
					Gjithsej cope	Nr i serial nga _____ deri _____

Bashkëngjitur këtij autorizimi janë modelet e miratuara të etiketës së furnizuesit dhe certifikatës së origjinës për fidanët frutorë.

Certifikuesi

emri, mbiemri e firma
vula

Lëshuar më _____ 201_
E vlefshme deri më 30 prill të një viti më pas.

Aneks 4

Model 6



KËRKESË PËR CERTIFIKIM
të materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore të kategorive Parabazë dhe Bazë

Drejtuar: _____ (Autoritetit certifikues) I nënshkruari
_____, në cilësinë e _____

kërkoj aprovimin e materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore të kategorisë _____ dhe
pajisje me Certifikatë Zyrtare si më poshtë vijon:

a) Të dhëna për kërkesin:

1. Emri e mbiemri : _____, Emërtimi i Subjektit(Firmës) _____
2. Adresa: e vendbanimit _____, e Zyrës _____
3. Aktiviteti që kryen: _____
4. Vendodhja e aktivitetit: _____
4. Kodi i kërkesit: _____, 5. Numri i licences: _____

b) Të dhëna për personin përgjegjës për krijimin e materialeve të shumëzimit të bimëve drufrutore të kategorisë _____:

1. Emri e mbiemri : _____
2. Adresa: e vendbanimit _____, e Zyrës _____
3. Arsimi: _____
4. Specializimi: _____

b) Të dhëna për materialet e shumëzimit që kërkohet të certifikohen:

Nr	Speciet, varietetet dhe ose, për nënshartesat, hibridet ndërmjet specieve.	Numri i bimëve të përftuara gjithsej	Vitet e krijimit	Mënyra aktuale e ruajtjes
	Gjithsej			
1.	Specia.....			
	Varieteti.....			

Bashkëngjitur kërkesës së përmendur më sipër është e gjithë praktika përzgjedhëse për krijimin e materialeve të shumëzimit të kategorisë _____.

Si nënim: Kërkesa paraqitet jo më vonë se me 30 prill.

Kërkesuesi

(emri e mbiemri, firma e vula)

_____, më _____ 201_

Aneks 4

Model 7

Autoriteti Certifikues _____

Nr. i serisë _____

CERTIFIKATË ZYRTARE

për materialet e shumëzimit të bimëve drufrutore, kategoria Parabazë dhe Bazë

Lëshuar: (emri e mbiemri) _____, (emërtimi i subjektit) _____,
Adresa: e vendbanimit _____,
Vendodhja e aktivitetit: _____
Kodi: _____

Bazuar në akt-verifikimin e mbajtur nga autoriteti certifikues me datë _____,
sipas ligjit Nr.10416, datë 07.04.2011, Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, pasi është
konstatuar se përmbushen kërkesat e përcaktuara,

Certifikon në kategorinë _____, materialet e shumëzimit që
vijnë:

b) Të dhëna për materialet e shumëzimit që kërkohet të certifikohen zyrtarisht:

Nr	Speciet, varietetet dhe ose, për nënshartesat, hibridet ndërmjet specieve.	Numri i bimëve gjithsej	Vitet e krijimit	Mënyra aktuale e ruajtjes
	Gjithsej			
1.	Specia.....			
	Varieteti.....			

Bashkëngjitur është akt-verifikimi i plotësuar nga personi i ngarkuar nga autoriteti i certifikimit për të mbikëqyrur plotësimin e kërkesave për certifikim zyrtar të materialeve të shumëzimit të kategorisë _____.

Certifikuesi

emri, mbiemri e firma
vula

Lëshuar më _____201__

Aneks 4

Model 7/1

Autoriteti Certifikues _____



Akt – verifikimi
Për plotësimin e kërkesave për certifikim zyrtar të Materialeve të shumëzimit të
kategorisë _____ (Parabazë ose bazë)

Nga verifikimi i kryer për gjendjen në terren dhe nga mbikëqyrja e dokumentacionit përkatës të mbajtur me datë _____ rezulton si vijon:

Nr	Kërkesat që duhet të plotësohen për t'u certifikuar zyrtarisht në Kategorinë _____	Plotësuar Po ose Jo	Në se Jo: Afati (nëse është e mundur) kur duhet të plotësohet	Vërejtje

Si përfundim: _____

(këtu personi i ngarkuar nga autoriteti certifikues jep opinionin personal lidhur me plotësimin ose jo të kërkesave për certifikim)

Personi i ngarkuar nga Autoriteti i Certifikimit

Furnizuesi / Kërkuesi

(emri e mbiemri, firma)

(emri e mbiemri, firma)

Aneksi 5

CERTIFIKATË ORIGJINE

(nxirret dhe plotësohet nga furnizuesi dhe ka vlerë pasi nënshkruhet nga certifikuesi)

1. Dërguesi: _____ Emër e mbiemër Adresa: _____ Adresa e vendodhjes së aktivitetit (NIPT ose Kodi fiskal _____)						REPUBLIKA E SHQIPËRISË			
2. Marrësi: Emër e mbiemër _____ Emërtimi i subjektit _____ Adresa e plotë: _____						3. Vendodhja e prodhuesit (Adresa e plotë)			
4. Informacion në lidhje me transportin						5. Vërejtje (shënim)			

6. Lista dhe sasia e materialeve të shumëzimit ose dhe fidaneve frutorë që dërgohen.										
Nr	Lloji i materialeve të shumëzimit ose fidanëve frutorë dhe specia	Varieteti ose, sipas rastit për nënshartesat Hibridi	Nënsh artesa për fidanet e shartuar	Kategoria	Sasia copë	Sasia e paketimeve sipas llojit të paketimit			Nr. i Lotit	Numrat serial të etiketave
						Kuti	Tufa			
	Fid frutore									
1.	Ulli									
	filiza									
1.	kumbulla									

Shënim: Kur lista është e gjatë bëhet një tabelë si kjo dhe i bashkëngjitet Certifikatës së Origjinës.
 Përdoruesve final të materialeve të shumëzimit dhe fidanëve të bimëve drufrutore përveç dokumentit të Flete – daljes i bashkëngjitet dhe një fotokopje e kësaj certifikate të origjinës të vërtetuar e vulosur njësisht me origjinalin nga vetë Furnizuesi (ndoshta furnizuesi është vetëm tregtar)

8. Autoriteti certifikues vërteton se materialet e shumëzimit (fare,) dhe ose fidanët frutorë (ulli,) të listuara më sipër janë me origjinë sipas përshkrimit në kuadratin 3 të kësaj table.	Certifikuesi _____ firma e vula Vendi dhe data e lëshimit, emri, nënshkrimi dhe vula e autoritetit kompetent Furnitori _____ firma e vula
---	--

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 10.4.2013
Doli nga shtypi më 10.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 52 lekë